



K.DH.SH.II.nr.978/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitja Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NNTP On Line Computers me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2525/19, të datës 01.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.07.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2525/19, të datës 01.07.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.2525/19, të datës 01.07.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NNTP On Line Computers me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.01.3.2.2/292/2017 i datës 19.09.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NNTP On Line Computers me seli në Prishtinë, t'ia kthej detyrimet e paguara më tepër në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 3,726.75€ (tre mijë, e shtatëqind e njëzet e gjashtë euro e shtatëdhjetë e pesë cent) të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-14821/06.04.2017 të lëshuar nga ZBD Prishtinë, si dhe t'ia paguaj kamatën vjetore ligjore prej

8% nga data kur është bërë pagesa e detyrimeve doganore, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar A.nr. 2525/19 të datës 01.07.2021 ta prishë si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/292/2017 i datës 19.09.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë NNTP On Line Computers me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimit numër R-14821/06.04.2017 të lëshuar nga ZBD Prishtinë, si të pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.10.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/292/2017 i datës 19.09.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata përmes ekspertizës

financiare datës 15.06.2021 dhe deklarimeve të ekspertës në seancë gjyqësore, ka siguruar provat se vlera e deklaruar e dokumentacionit përcjellës të mallit doganor është e harmonizuar me transaksionet bankare dhe dokumentacionet tjera si deklarata eksportues, fatura e mallit, pro fatura, Ekspertja financiare në seancë gjyqësore ka precizuar vlerën e diferencës së shtuar në taksa doganore prej 3,726.75 €. Pala paditëse ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës, pro faturën përcjellëse të mallit, urdhërpagesat ndërkombëtare datës 31.03.2017 dhe 04.05.2016 në “....” të cilat pagesa janë bërë pikërisht për faturën përcjellëse të mallit me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, deklaratën e shtetit eksportues nga Zvicra, faturën e shpenzimeve të transportit të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj gjykata konstaton se janë përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore R-14824/06.04.2017 në ZBD Prishtinë. Gjykata konstaton se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura eksport në Kosovë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-

së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruara prova për të vërtetuar gjendjen faktike por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit, duke konsideruar se aktgjykimi në fjalë përmban shkelje të dispozitave materiale respektivisht në nenit 34 të KDAK-së e që Dogana e Kosovës për vlerën e mallrave të importuar kur nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 dhe 34 çmimin e mallrave do të përcakton në bazë të dhënave metodave tjera të parapara në KDAK. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse nga provat materiale gjykata ka konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit dhe përmbush kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturave përcjellëse të mallit, pasi që nga transaksionet bankare që dëshmojnë vlerën reale të paguar të mallit lëndor, malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të KDAK, respektivisht sipas vlerës së transaksionit që praqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë. Gjykata ka konstatuar se në transferet bankare janë të cekura detajet e përfituesit të pagesës, numri i faturave përcjellëse të mallit, përshkrimi i mallit për të cilën i është bërë pagesa shitësit-eksportuesit të mallit, prandaj e paditura është dashur ti pranohet këto pagesa të mallit që dëshmojnë se është paguar vlera e transaksionit përderisa e paditura nuk ka mundur të konstatoj se është paguar një vlerë më e lartë se sa vlera e deklaruar. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me rastin e përcaktimit të vlerës së detyrimeve doganore të paguara më tepër në emër të taksave doganore nga paditësi sipas DUD kontestues ka marrë për bazë vlerën që ka llogarit dhe precizuar ekspertja financiare e cila ia ka dorëzuar gjykatës ekspertizën financiare të datës 15.06.2021 të cilat janë pranuar nga palët ndërgjyqëse dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ekspertja financiare deklaroi dhe precizoi vlerën e kontestit nga pagesa e detyrimeve doganore ashtu që vlera e saktë e detyrimeve doganore të paguara me tepër në bazë të DUD-it R-14821/06.04.2017 të lëshuar nga ZBD Prishtinë, rezulton të jetë shuma prej 3,726.75€. Në rastet e ngjashme kur e paditura bën rivlerësimin e mallit doganor në bazë të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109 respektivisht sipas të dhënave të disponueshme pa i shqyrtuar paraprakisht dispozitat e nenit 33 të KDA, vlerësimi i mallit doganor sipas Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk bëhet vetëm në bazë të propozimeve çmimeve të disponueshme nga Sektori i Vlerës i Doganës së Kosovës, kështu që në këtë procedurë të konfliktit administrativ

gjkata nga provat e administruara ka konstatuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor është i harmonizuar në kuptim të vlerës së deklaruar që parashihet me nenin 123 të UA nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, i cili ka paraparë se dokumentet që duhet ti bashkëngjiten DUD për vendosje të mallit në qarkullim të lirë është fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave siç kërkohet me nenin 91 të këtij Udhëzimi Administrativ. Andaj në kontekst të argumenteve ligjore dhe faktike dhe duke marr parasysh se e paditura Dogana e Kosovës edhe në procedurën e rivendosjes nuk i ka vërtetuar faktet esenciale ka nxjerr konkluzion jo të drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, nuk ka zbatuar drejt dispozitat e legjislacionit doganor. Gjithashtu gjykata në këtë konflikt administrativ posedon prova të mjaftueshme për të vendosur në mënyrë meritore këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 81.1 par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 nenit 43 par.3, 46 parag.4 të LKA-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.978/22, me datë 03.07.2023

**Kryetar i kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**